



Prishtinë: 13.06.2018

Kodi i ZRRE-së: V\_996\_2018

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët;
- Rekomandimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_R\_1601\_08\_17**;

në seancën e mbajtur më datë 13.06.2018, nxori këtë:

### V E N D I M

- I **APROVOHET** ankesa e konsumatorit D. G., nga fshati Reqan, Prizren, si në arsyet e paraqitura në këtë rekomandim.
- II **OBLIGOHET**, KESCO që të shkarkoj konsumatorin me shifër DPZ - 9032960 nga korrigjimi nr.44260DPZ-9032960-9032960 i datës 19.11.2014 në vlerë 5,068.49€.

### A r s y e t i m

Pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji me datë 03.12.2015 konsumatori D. G. i NTSH "Sedtours" ka parashtruar ankesë me të cilën ka kundërshtuar përgjigjen e Departamentit për Konsumator në KESCO lidhur me faturimin jo real të energjisë elektrike në vlerë prej 5068.49€ nga ana e KESCO-s.

Bordi i ZRRE-së, me qëllimit të vërtetimit të plotë gjendjes faktike e cila është iniciuar nga palët në kontest lidhur me pikën matëse të theksuar më lartë ka shqyrtuar dhe analizuar në detaje të gjitha dëshmitë e mbledhura për veprimet e ndërmarra nga palët në kontest lidhur me këtë pikë matëse.

Me datë 10.10.2014 punëtorët e autorizuar të KEDS-it të autorizuar për inspektimin e Grupeve Matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë evidentuar të dhënat teknike, si dhe gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 96256086, ku energjia aktive në momentin e inspektimit ka qenë TL=19605,40 kWh dhe TU=4376,20 kWh, energjia reaktive ka qenë TL=16829,60 kVar dhe TU=3248,40 si dhe maksigrafi TL=3,3112 kW dhe TU=1,1736 kW.

**Provë:** Raporti mbi kontrollimin-pranimin e Grupit Matës nr.006468 të datës 10.10.2014

Departamenti i faturimit në KESCO me datë 19.11.2014 e ka ngarkuar konsumatorin me korrigjimin plotësues nr.44260DPZ-9032960 në vlerë financiare 5,068.49€ duke bërë korrigjimin plotësues për faturat e periudhës 11/2013 - 10/2014 bazuar në procesverbalin nr. 006468 e datës 10.10.2014.

**Provë:** Korrigjimi nr. 44260DPZ-9032960 datë 19.11.2014

Me datë 29.01.2015 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar korrigjimin plotësues nr.44260DPZ-9032960 të datës 19.11.2014.

**Provë:** Ankesa e konsumatorit e datës 29.01.2015



Me datë 19.03.2015 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike, si dhe procesverbalit mbi kontrollimin-pranimin e Grupit Matës nr. 006468 të datës 10.10.2014.

**Provë:** Përgjigja e KESCO-s e datës 19.03.2015

I pakënaqur me përgjigjen e KESCO-s konsumatori me datë 03.12.2015 ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjen e lëshuar nga KESCO si dhe ka kërkuar ti shqyrtohet korrigjimi plotësues nr. 44260DPZ-9032960 të datës 19.11.2014.

**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së e datës 03.12.2015

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Raportin mbi kontrollimin-pranimin e Grupit Matës nr. 006468 i datës 10.10.2014 në të cilën raport punëtorët e autorizuar të KEDS-it të autorizuar kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe gjatë inspektimit kanë evidentuar të dhënat teknike, si dhe gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr.96256086, ku energjia aktive në momentin e inspektimit ka qenë TL=19605,40 kWh dhe TU=4376,20 kWh, energjia reaktive ka qenë TL=16829,60 kVar dhe TU=3248,40 si dhe maksigrafi TL=3,3112 kW dhe TU=1,1736 kW. Bordi ka vërejtur se në raport punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë evidentuar se inspektimi i pikës matëse bëhet pasi që nga AMR është konstatuar se vlerat e tensionit të fazës së dytë janë mjaftë të ulëta. Bazuar në verifikimin e bërë, punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë konstatuar se izolimi i tensioneve në fazën e dytë është shkrirë dhe përçuesi është oksiduar. Punëtorët e autorizuar të KEDS-it po ashtu kanë evidentuar se është bërë pastrimi i përçuesit, është bërë izolimi i tensionit, si dhe kanë evidentuar në raport se duhet të bëhen korrigjimet e nevojshme sipas të dhënave të matura nga AMR për rastet kur tensionet kanë qenë mjaft të vogla.

**Provë:** Raporti mbi kontrollimin-pranimin e Grupit Matës nr. 006468 i datës 10.10.2014

KEDS ka ofruar raportin e përgatitur nga sektori i AMR-së lidhur me humbjet e mundshme (energjia e pamatur) të cilat janë krijuar sipas analizave të tyre për shkak të tensioneve të ulëta për një periudhë të caktuar kohore. Në raportin e përpiluar nga KEDS thuhet se defektet në matje kanë filluar nga periudha 21.11.2013 dhe kjo gjendje është rregulluar pas ndërhyrjes së ekipeve të KEDS-it me datë 10.10.2014 e që i bie se këto defekte sipas KEDS kanë zgjatur për një periudhë njëmbëdhjete mujore. Sipas raportit defektet janë realizuar për perioda të shkurta 15 minutshe dhe se analiza e rikthimit të energjisë së pa matur është bërë bazuar në këto perioda. Në raport është potencuar se pas një ndërrimi të rreth rrotullimit RST diku pas datës 15.07.2014 defekti i njëjtë në primar të njehsorit ka kaluar nga faza L3 në fazën L2, e që kjo është marr edhe si periudhe ndarëse për korrigjimin e energjisë së pa matur, ku nga dhjetori 2013 deri në qershor 2014 faturat e konsumatorit do të korrigjohen me 22.58%, kurse nga korriku deri në tetor 2014 me 10.86%. Bordi ka analizuar të dhënat e paraqitura në raport, si dhe mënyrën e korrigjimit të bërë nga KEDS dhe konstaton se një korrigjim i tillë me koeficientet e përcaktuar, 22.58% dhe 10.86% është jo real të përcaktohet, e në veçanti që është theksuar se gabimi në matje ka ndodhur se pari në L3 duke kaluar në L2 për shkak të rreth rrotullimit RST diku pas datës 15.07.2014 duke mos përcaktuar kohën e saktë edhe përkundër faktit se analizat janë bërë sipas të dhënave të nxjerra nga sektori i AMR-së (Leximi automatik i njehsorit, apo AMR, është teknologjia e mbledhjes automatike të të dhënave të konsumit, diagnostikimit dhe statusit nga pajisjet matëse të energjisë dhe kalimin e këtyre të dhënave në një bazë të dhënash qendrore për faturim). Po ashtu në raportin mbi kontrollimin-pranimin e Grupit Matës nr. 006468 të datës 10.10.2014 punëtorët e KEDS-it kanë konstatuar se vetëm izolimi i tensioneve në fazën e dytë është shkrirë dhe përçuesi është oksiduar, e që pastaj janë marr të gjitha masat e nevojshme për rregullimin e izolimit.

**Provë:** Raporti nga sektori i AMR në KEDS

Bordi i ZRRE-së ka analizuar shpenzimin e përgjithshëm të energjisë elektrike dhe ka konstatuar se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore, por që edhe në periudha të



ndryshme kohore ka luhatje. Bordi duke pasur parasysh luhatjet e shpenzimit të konsumatorit, si dhe pretendimet e KEDS se njehsori elektrik nga periudha 21.11.2013 deri më 10.10.2014 nuk ka bërë matje të saktë, ka bërë krahasimet e shpenzimeve të energjisë elektrike për dy periudha të ndryshme para dhe pas ndërhyrjes, për të parë më saktë se si ka rrjedhur shpenzimi i energjisë elektrike. Për periudhën para ndërhyrjes (para periudhës kontestuese): periudha 01/2012 deri me 12/2012 mesatarja mujore e shpenzimeve të energjisë elektrike është 497(\*50 konstanta) kWh/muaj, periudhën 01/2013 deri me 12/2013 mesatarja mujore e shpenzimeve të energjisë elektrike është 635(\*50 konstanta) kWh/muaj, kurse për periudhën pas ndërhyrjes (pas periudhës kontestuese): periudha 01/2015 deri me 12/2015 mesatarja mujore e shpenzimeve të energjisë elektrike është 490(\*50 konstanta) kWh/muaj, si dhe periudhën 01/2016 deri me 12/2016 mesatarja mujore e shpenzimeve të energjisë elektrike është 470(\*50-konstanta) kWh/muaj. Mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike gjatë periudhës 01/2014 e deri më 12/2014 është 431.5(\*50-konstanta) kWh/muaj. Pra nga analiza e bërë shpenzimit të energjisë elektrike aktive sipa viteve vërtetohet se nuk ka ndryshim të madh të shpenzimit të energjisë elektrike para, gjatë dhe pas periudhës kontestuese. Bazuar në këto analiza është vështirë të vërtetohet se njehsori i konsumatorit për shkak të tensioneve të ulëta në perioda të ndryshme të shkurta e në veçanti duke mos e përcaktuar kohën e saktë nga ana e KEDS-it nuk ka bërë matje të saktë.

**Provë:** Rrjedha e energjisë elektrike

Me datë 19.11.2014 Departamenti i faturimit në KESCO e ka ngarkuar konsumatorin me korrigjimin plotësues nr. 44260DPZ-9032960 në vlerë financiare 5,068.49€ duke bërë korrigjimin plotësues për faturat e periudhës 11/2013 - 10/2014 bazuar në procesverbalin nr. 006468 të datës 10.10.2014 përkatësisht ka bërë korrigjimet e faturave per periudhën 12/2013 - 06/2014 me faktorin korrigjues +22.58%, kurse për periudhën 07/2014 – 10/2014 me faktorin korrigjues +10.86%. Bordi i ZRRE-së konstaton se deri tek ky korrigjim është vështirë të arrihet duke marr për bazë se defektet e mundshme në matjen e njehsorit sipas KEDS kanë ndodhur për periudha të shkurtra 15 minutëshe duke mos argumentuar saktë kohëzgjatjen e këtyre defekteve, si dhe ndikimin e tensioneve të ulëta për periudhat tjera duke pasur parasysh se konsumatori ka pasur shpenzim përgjatë 24 orëve.

**Provë:** Korrigjimi nr. 44260DPZ-9032960 datë 19.11.2014

Bordi i ZRRE-së thekson se bazuar në Kodin e Matjes të OSSH përkatësisht nenin 4.3.2 përcaktohen qartë detyrimet e OSSH-së lidhur me inspektimin dhe testimin e njehsorëve brenda periudhave të caktuara kohore si dhe përgjegjësinë mbi operimin dhe mirëmbajtjen e njehsorëve elektrik. Ne nenin 4.3.2 thuhet se: "Operimi dhe mirëmbajtja e Sistemit të njehsorit përfshinë instalimin e bërë në bazë të standardeve të kërkuara, mirëmbajtjen e rregullt, kontrollimin e TMRR, TMT, dhe njehsorëve tjerë, instalimin e përçuesve, terminalet, shtrirjen e mirëfilltë të kablllove, mbrojtjen, pastrimin dhe gjendjen e lidhjeve të kutive të njehsorëve, gjendjen e plumbave, leximin ditor të rregullt të njehsorëve si dhe nxjerrjen e të dhënave nga pajisja për lexim, nga Qendra Grumbulluese e të Dhënave si dhe kushtimit të vëmendjes për ndonjë prishje eventuale të sistemit të njehsorëve matës. Bazuar në dokumentacionin e ofruar nga KEDS vërtetohet se sektori i AMR i cili është përgjegjës për leximin automatik të njehsorit, diagnostikimit dhe statusit nga pajisjet matëse të energjisë nga periudha 21.11.2013 deri më 10.10.2014 nuk ka ndërmarr asnjë hap për të ndërhyrë në matjen jo të saktë të njehsorit elektrik. Andaj lidhur me këtë KEDS/KESCO nuk ka arritur të na argumentojë se korrigjimi plotësues nr. 44260DPZ-9032960 i datës 19.11.2014 ka qenë si rezultat i defekteve të cekura më lartë, pasi që sipas shkresave të lëndës Bordi i ZRRE-së nuk ka mundur të vërejë që njehsori elektrik nuk ka regjistruar saktë, por që konsumatori është faturuar sipas shpenzimeve reale në njehsor.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 13.06.2018 ka konstatuar se duke pasur parasysh të gjitha faktet e përmendura më lartë, e në veçanti rrjedhën e energjisë elektrik, Raporti mbi



kontrollimin-pranimin e Grupit Matës nr.006468 të datës 10.10.2014, si dhe përgjegjësit e OSSH-së të dhëna me kodin e matjes, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 13.06.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Arsim Janova, u.d. kryesues

---

Besim Sejfiqaj, anëtar

---

Selman Hoti, anëtar

---

Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Konsumatorit: D. G.,
- KESCO-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së.